



INTERNATIONAL MONETARY FUND



Njoftim për Shtyp nr. 14/416  
PËR SHPËRNDARJE TË MENJËHERSHME  
10 Shtator 2014

Fondi Monetar Ndërkombëtar  
Uashington, D.K. 20431 SHBA

### **Deklaratë pas misionit të FMN-së në Shqipëri**

Një ekip i stafit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) i udhëhequr nga Nadeem Ilahi vizitoi Tiranën gjatë periudhës 26 gusht deri në 9 shtator 2014 për të zhvilluar diskutime në kuadër të shqyrtimit të dytë nën marrëveshjen *Fondi i Zgjeruar* (EFF).

Ekipi diskutoi një sërë çështjesh me autoritetet, përfshirë buxhetin e vitit 2015, reformat strukturore, si dhe qeverisjen e Bankës së Shqipërisë dhe kuadrin e politikave. Diskutimet dhe përfundimi i shqyrtimit do të vazhdojnë nga Uashingtoni dhe misioni do të kthehet për të përfunduar punën e tij në një datë të mëvonshme.